

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj - kryetar i kolegjit dhe Gani Avdiu dhe Rrustem Thaçi anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) Sh.A. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj S.TH., kundër të paditurit XH.S. nga fshati ... komuna e Rahovecit, për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – dega në Rahovec C.nr.209/2009, të datës 24.03.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 20.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditurit XH.S. nga fshati ...komuna e Rahovecit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – dega në Rahovec C.nr.209/2009, i datës 24.03.2014, **VËRTETOHET**, përveq pjesës për kamatën e cila **NDRYSHOHET** dhe gjykohet me kamatë sikurse për mjetet e deponuara në bankat komerciale të Kosovës, në afat mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 24.03.2014, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.209/2009, të datës 24.03.2014, në pjesën e parë të dispozitivit e ka obliguar të paditurin që brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi t’ia paguaj paditëses shumën prej 90,91 euro, në emër të borxhit, me kamatë 3.5 %, të llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, ndërsa me pjesën e dytë të dispozitivit është obliguar i padituri që në emër të shpenzimeve procedurale, t’ia paguaj paditëses shumën prej 30 euro, më gjerësisht sikurse në aktgjykimin e atakuar.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës ndërsa aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ose aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 16.07.2009, në Gjykatën Komunale në Rahovec, paditësja, ka paraqitur padi kundër të paditurit për shkak të borxhit në emër të shfrytëzimit të shërbimeve të telefonisë fikse, në shumën prej 90,91 euro me kamatë në lartësi prej 3.5%, duke e llogaritur atë nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Në procedurën sipas padisë gjykata e shkallës së parë ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave ka marrë aktgjykimin e atakuar me të cilin e ka detyruar të paditurin që t'ia paguajë borxhin paditëses në shumën prej 90,91 euro. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata ka theksuar se e paditura me asnjë provë nuk ka arritur të dëshmojë se nuk i ka shfrytëzuar shërbimet e paditëses dhe në këtë drejtim ekziston detyrimi i të paditurës në pagesën e borxhit ndaj paditëses.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa pretendimet tjera për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga ana e ankueses nuk janë paraqitur.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit ka administruar provat e paraqitura nga palët ndërgjyqësore me të cilat ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në arsyetim të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur dispozitës së nenit 160 paragrafi 4 i LPK-së, në atë mënyrë që ka përshkruar kërkesat e palëve, faktet që kanë parashtruar palët, provat e propozuara dhe të administruara, si dhe mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar, pasi që me dispozitën e nenit 148 paragrafi 1 të LMD-së (i vitit 1978) përcaktohet se *”kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese”*, ndërsa me dispozitën e nenit 262 paragrafi 1 parashihet se *”kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret drejtë është zbatuar e drejta materiale, e për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset zyrtarisht, përveq për pjesën e kamatës së gjykuar, për të cilën Gjykata e Apelit gjen se është bërë zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, andaj në këtë pjesë gjykata e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar vetëm sa i përket aplikimit të kamatës, duke e gjykuar kamatën sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit e pa destinim të caktuar, e cila paguhet në bankat komerciale të

Kosovës, të llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë. 24.03.2014, e deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 277 të LMD.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 2682/14, me datë 20.03.2018

Kryetari i kolegjit
Valon Totaj